

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANE

N. \_\_\_\_ REP. 5875  
N. \_\_\_\_ KOL. 1784



**PROÇESVERBAL I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
ALMOD SH.P.K. DATË 06.12.2005**

Më datë 06.12.2005, në orën 14.00, përpara meje Noteres Arjana Mallkuçi, në selinë e Studio Legale Tonucci, në adresën Rr. A. Toptani, Torre Drin, Kati i Dytë, është mbajtur Asambleja e Ortakëve të shoqërisë Almod sh.p.k. me pjesëmarrjen e

1. Zonja Valentina Pine, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 13.8.1955, nr. pasaporte 0915226, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Ekonomisë (më poshtë, "Ministria"), ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 81,83% të kapitalit themeltar të shoqërisë Almod Sh.p.k. (më poshtë "Almod" ose "Shoqëria"), në bazë të autorizimit bashkëngjitur këtij procesverballi (shtojca 1);
2. Av. Erinda Ballanca, lindur dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, më 29.10.1973, dhe Av. Klotilda Ferhati, lindur në Tiranë, Shqipëri më 11.4.1979, nr. pasaporte 0245131, në cilësinë e përfaqësueseve të Shoqërisë të së drejtës italiane Simod S.p.A., ortak i cili zotëron një kuotë të barabartë me 18,17% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, në bazë të prokurës së bashkëngjitur këtij procesverballi (shtojca 2).

Gjithashtu është i pranishëm në cilësinë e të ftuarit edhe administratori i shoqërisë Z. Avni Golaj.

Merr përsipër drejtimin e Asamblesë Znj. Valentina Pine, dhe cakton sekretare Av. Klotilda Ferhati. Kryetarja deklaron se Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë është mbledhur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur për sa më poshtë vijon

***rendi i ditës***

1. Dhënia me qira e ambjenteve dhe makinerive të Shoqërisë, kërkuar nga shoqëria Ereci sh.p.k.;
2. Prishja e Shoqërisë që rrjedh nga përfundimi i afatit të përcaktuar në nenin 4 të Statutit të Shoqërisë;
3. Shpalljen e Shoqërisë në likuidim dhe emërimin e likuidatorëve;

***Pasi u konstatua***

Prania e ortakëve që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë, Kryetarja

***deklaron***

Asamblenë e mbledhur në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës.

*Handwritten mark*

*Handwritten initials: Kf and CPG*